



INSTITUTE FOR THE PROMOTION OF
SOCIAL & ECONOMIC DEVELOPMENT



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

Politikat e Përbashkëta Bujqësore të Bashkimit Evropian, Institucionet përgjegjëse dhe ndikimi i tyre mbi prodhimin dhe tregtimin e produkteve organike në Shqipëri.

Projekti

“Përmirësimi i njohurive të fermerëve të bujqësisë organike në lidhje me procesin e Integrimit Evropian”

Ekspert Ligjor Z. Andi Nano

Ky projekt bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet IPA II European Union Integration Facility 2014 "Mbështetje e organizatave të shoqërisë civile për zbatimin e ngritjes së kapaciteteve për aksione që do rrisin dialogun e politikave dhe ndërgjegjësimin për integrimin në Bashkimin Evropian", i cili menaxhohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (CFCU) dhe zbatohet nga IPSED në partneritet me organizatën ISP.

Struktura e prezantimit

1. Përshkrim i shkurtër mbi institucionet e Bashkimit Evropian.
2. Politika e Përbashkët Bujqësore në BE.
3. Procesi “Screening” gjatë negociatave.

1. Përshkrim i shkurtër mbi institucionet e Bashkimit Evropian

- Prezantimi i Bashkimit Evropian.
- Traktatet
- Si i merr BE vendimet?
- Parlamenti Evropian
- Këshilli i Bashkimit Evropian
- Komisioni Evropian
- Gjykata e Drejtësisë
- Gjykata Evropiane e Auditorëve
- Komiteti Ekonomik dhe Social
- Komiteti i Rajoneve
- Banka Evropian për Investime
- Banka Qendrore Evropiane
- Ombudsmani Evropian
- Mbikëqyrësi Evropian i të Dhënave
- Agjencitë

2. Politika e Përbashkët bujqësore në BE

- PPB – zhvillimi dhe reformat kryesore.
- Ndikimi i PPB në intergrimin e tregut bujqësor - Qëllimet dhe objektivat.
- Sektorët e mbuluar nga PPB.
- Pesë objektivat e te traktatit dhe zbatimi i tyre.
- Rregullorja e OMGJ në Bashkimin European.
- Legjislacioni European dhe ai Shqiptar për produktet organike.
- Ndikimi i PPB në Shqipëri.
- Anakronime

Procesi “Screening” gjatë negociatave

- Procesi Screening.
- Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural.
- Prioritetet kryesore gjatë negocimit.
- Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare.
- Struktura shtetërore e negociatave.
- Platforma e partneritetit për integrimin Evropian (IX).

Bashkimi Evropian

Pse Bashkimi Evropian ?



Bashkimi Evropian është një bashkim politik dhe ekonomik i 28 shteteve anëtare që janë të vendosura kryesisht në Evropë. Ai ka një sipërfaqe prej 4,475,757 km² dhe një popullsi prej rreth 510 milion.

BE ka ofruar paqe dhe prosperitet në Evropë, një monedhë të vetme Evropiane (euro) dhe një ‘treg unik’ pa kufij ku mallërat, njerëzit, shërbimet dhe kapitali lëvizin lirshëm. BE është bërë fuqia më e madhe tregtare, dhe lider botëror në fushat si mbrojtja e mjedisit dhe ndihma për zhvillim.

Shtetet që e përbëjnë BE-në (“shtetet anëtare”) mbesin shtete të pavarura sovraane por ato e bashkojnë sovranitetin e tyre në mënyrë që të marrin fuqi dhe ndikim në nivel botëror, të cilën asnjëra nuk do ta kishte vetëm me kapacitetin e tyre.

Evropa deri në gjysmën e dytë të shekullit të 20 ishte e karakterizuar nga dallime gjuhësore, fetare dhe kulturore. Shtetet e saj kishin dallime ekonomike dhe dallime në sistemet politike. Marrëdhëniet ndërmjet shteteve të Evropës ishin të bazuara në rivalitet dhe në mosbesim, kurse tensionet që buronin nga marrëdhëniet e këtilla shkaktuan edhe dy luftërat botërore. Pasojat që i la Lufta e Dytë Botërore pothuajse në tërë kontinentin e Evropës ishin të përmasave tejte të mëdha – ekonomia e shkatërruar, vendbanime të rrënuara dhe miliona të vdekur.

Bashkimi European u krijua :

- Për të përmirësuar kushtet e zhvillimit të tregëtisë mes vendeve të Evropës dhe me shtetet e tjera
- Për të siguruar një mbrojtje më të mirë të shteteve anëtare nga rreziqet natyrore dhe luftërat.
- Për të përmirësuar kushtet e punës dhe jetesës së popullsisë së saj duke siguruar një zhvillim ekonomik dhe social të qëndrueshëm.

1. Institucionet e Bashkimit Evropian

Vendimarrja Brenda Bashkimit European

Tre institucionet kryesore vendim-marrëse janë:

Parlamenti Evropian, që përfaqëson qytetarët e BE-së dhe që në mënyrë direkte zgjidhet nga ata çdo 5 vjet;
◦ Parlamenti miraton ligje, miraton buxhetin e BE dhe mbikqyr institucionet e BE.

Këshilli i Bashkimit Evropian, që përfaqëson shtetet anëtare. Një Ministër nga çdo shtet anëtar. Miratimi i vendimeve bëhet në bazë të numurit të votave. Ai ka për detyrë të:

1. Të miratojë ligjet evropiane. Në shumë sfera këtë e bën së bashku me Parlamentin Evropian.
2. Të koordinojë politikat ekonomike dhe sociale të shteteve-anëtare.
3. Të realizojë marrëveshje ndërkombëtare mes BE-së dhe një ose më shumë shteteve apo organizatave ndërkombëtare.
4. Të aprovojë buxhetin e BE, së bashku me Parlamentin Evropian.
5. Të zhvillojë Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE
6. Të koordinojë bashkëpunimin mes gjykatave nacionale dhe forcave policore lidhur me çështjet e krimit.

Komisioni Evropian, është krah ekzekutiv i BE dhe iniciator i propozimeve legislative që ka për qëllim të mbështesë interesin e Unionit si tërësi. Komisioni është institucion i pavarur politikisht nga qeveritë e shteteve. Komisioni Evropian ka katër role kryesore:

1. T'i propozojë ligje Parlamentit dhe Këshillit;
2. Të menaxhojë dhe zbatojë politikat dhe buxhetin e BE-së;
3. Të zbatojë ligjin evropian (së bashku me Gjykatën e Drejtësisë);
4. Të përfaqësojë Bashkimin Evropian në skenën ndërkombëtare, për shembull duke negociuar marrëveshje me BE-së dhe shteteve tjera.

“Trekëndëshi institucional” prodhon politika dhe sjell ligje që zbatohen në gjithë BE-në. Në parim, është Komisioni ai që propozon ligjet e reja, por Parlamenti dhe Këshilli i miratojnë ato.

Institucione të tjera të rëndësishme të Bashkimit Evropian.

Gjykata e Drejtësisë. Detyra e saj është të sigurojë se legjislacioni i BE-së interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë në çdo shtet-anëtar. Një gjyqtar nga çdo vend i BE-së.

Gjykata e Auditorëve kontrollon që fondet e BE shfrytëzohen në mënyrë të përshtatshme. Një gjyqtar nga çdo vend i BE-së. Roli kryesor i Gjykatës është të kontrollojë që buxheti i BE-së është zbatuar/përdorur në mënyrë korrekte, me fjalë tjera, të sigurojë se të ardhurat dhe shpenzimet e BE-së janë ligjore dhe të ndershme, si dhe të sigurojnë menaxhim korrekt financiar.

Organet e tjera që kanë rol në bërjen e BE-së funksionale:

Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social - përfaqëson lojtarët ekonomik dhe social në shoqërinë civile të organizuar, sikur janë punëdhënësit dhe punëmarrësit, sindikatat dhe organizatat e konsumatorëve. Ka 344 anëtarë.

Numri i secilit shtet të BE-së paraqet pak a shumë madhësinë e popullsisë së saj.

Ai ka tri role:

1. të këshillojë Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komisionin Evropian; ose me kërkesë të tyre ose me vetiniciativë të Komitetit;
2. të inkurajojë shoqërinë civile që të përfshihet më shumë në procesin e vendimmarrjes të BE-së;
3. të mbështesë dhe nxisë rolin e shoqërisë civile në shtetet që nuk janë anëtare të BE dhe të ndihmojë për të formuar struktura këshillëdhënëse.

Komiteti i Rajoneve përfaqëson autoritetet rajonale dhe lokale. Ai është zëri i qeverisë rajonale dhe lokale. Përfaqëson autoritetet rajonale dhe lokale evropiane. Roli i Komitetit të Rajoneve është që mendimet dhe propozimet lokale e rajonale t'i inkuadrojë në legjislacionin e BE-së. Këtë e bën duke shprehur 'mendime' lidhur me propozimet e Komisionit.

Banka Evropiane për Investime financon investimet në projekte të zhvillimit ekonomik brenda dhe jashtë BE-së, dhe ndihmon bizneset e vogla nëpërmes Fondit Evropian të Investimeve;

Prioritetet e saj në BE janë që të mbështesin:

- kohezionin dhe konvergjencën,
- ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
- qëndrueshmërinë mjedisore,
- inovacionin,
- zhvillimin e rrjeteve trans-Evropiane të transportit, dhe energjinë e qëndrueshme, konkurrencte dhe të sigurtë.

Jashtë BE-së, BEI përkrahin politikat zhvillimore dhe të bashkëpunimit të BE-së në vendet kandidate dhe ato potenciale kandidate, shtetet e Mesdheut dhe Evropës lindore (përfshirë Rusinë). Huazimi në këto vende fokusohet në:

- zhvillimin e sektorit privat,
- zhvillimin e infrastrukturës,
- sigurimit të furnizimit me energji, dhe
- qëndrueshmërisë mjedisore.

Banka Qendrore Evropiane është përgjegjëse për stabilitetin e çmimeve në zonën e euros dhe të bëjë politika monetare për politikën monetare evropiane.

Ombudsmani Evropian heton ankesat lidhur me keq administrimin nga institucionet dhe organet e BE-së. Shembuj të keqadministrimit janë:

- jo-korrektësia,
- diskriminimi,
- keqpërdorimi i pozitës,
- mungesa e informatave ose refuzimi për të informuar,
- vonesat e panevojshme,
- procedurat e gabuara.

Mbikëqyrësi Evropian i të Dhënave mbrohet privacinë e të dhënave personale. Detyra e tij është të mbrojë të dhënat personale të proceduara nga institucionet e BE-së. Kur institucionet dhe organet e BE-së procesojnë të dhëna personale lidhur me një person të identifikueshëm, ata duhet të respektojnë të drejtën e privatësisë së atij personi. MEMD siguron se kjo do të ndodhë.

“Proçesimi” përfshin aktivitetet siç janë mbledhja e të dhënave, regjistrimi dhe ruajtja e tyre, marrja e tyre për konsultim, dërgimi dhe vënia e tyre në dispozicion të njerëzve tjerë, dhe poashtu bllokimi i tyre, zhdukja dhe shkatërrimi i tyre.

TRAKTATET

Fuqitë dhe përgjegjësitë e institucioneve të BE-së, dhe rregullat dhe procedurat që ato duhet ndjekur, janë të përcaktuara në Traktatet të cilat themeluan BE-në. Traktatet miratohen nga kryetarët dhe kryeministrat e të gjitha shteteve të BE-së dhe pastaj ratifikohen nga parlamentet e tyre.

Është Komisioni Evropian ai që propozon legjislacionin e ri, por Këshilli dhe Parlamenti i miratojnë ligjet. Në disa raste, Këshilli mund të veprojë i vetëm.

Institucionet e tjera të BE kanë gjithashtu një rol shumë të rëndësishëm për të luajtur.

Acquis communautaire

Acquis është tërësia e objektivave të Bashkimit Europian, politikat e tij dhe rregullat që rregullojnë këto politika. Acquis është gjithë legjislacioni i BE i cili është vazhdimisht në zhvillim ashtu siç edhe evolon Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare janë të detyruara të respektojnë *acquis communautaire* sepse ligji i BE-së ka përparësi ndaj ligjit kombëtar. Vendet kandidate duhet të pranojnë *acquis* dhe ta integrojnë atë në sistemin e tyre juridik përpara se të mund të anëtarësohen në Bashkimin Evropian.

Format kryesore të legjislacionit

Format kryesore të legjislacionit të BE-së janë **direktivat** dhe **rregulloret**. Direktivat krijojnë objektiva të përbashkët për të gjitha shtetet anëtare, por i lejojnë hapësirë autoriteteve nacionale të vendosin për formën dhe metodën e arritjes së asaj objekte.

Rregulloret zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjithë BE-në sa më parë që hynë në fuqi pa ndonjë akt të mëtejshëm për shtetet anëtare.

Procedura e zakonshme legjislative

Shkurtimisht, procedura është si më poshtë:

Komisioni shkruan një tekst i cili është propozimi i tij për një akt të ri ose të rishikuar. Komisioni e shkruan tekstin pas një procesi të gjerë konsultimi, i cili mund të bëhet në mënyra të ndryshme (vlerësimi i ndikimit, raportet nga ekspertët, konsultimi i ekspertëve kombëtar, organizatat ndërkombëtare dhe / ose organizatat joqeveritare, konsultimi përmes letrave jeshile dhe të bardha, etj.) Një proces konsultimi gjithashtu fillon ndërmjet departamenteve të ndryshme të Komisionit për të siguruar që të gjitha aspektet e çështjes në fjalë janë marrë parasysh.

Teksti i propozuar i Komisionit është miratuar më pas nga Kolegji i Komisionerëve publikohet më pas në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian (Seritë C). Njëkohësisht, teksti i propozuar i dërgohet Parlamentit Evropian, Këshillit, të gjitha parlamenteve kombëtare dhe, në varësi të fushës së politikës, në Komitetin Ekonomik dhe Social dhe / ose në Komitetin e Rajoneve të BE.

Këshilli dhe Parlamenti Evropian bën shqyrtimin zyrtar dhe ndryshimet e mundshme të tekstit. Ky është një proces përsëritës - ndryshimet që propozohen nga një institucion për shqyrtimin e tjetrit deri në dy lexime në secilin institucion. Qëllimi është të përftohet një tekst që është i pranueshëm si për Këshillin ashtu edhe për Parlamentin Evropian.

Në rast se, pas dy leximeve në secilin institucion, Këshilli dhe Parlamenti Evropian nuk kanë arritur marrëveshje për një tekst të përbashkët, ata hyjnë në një proces të njohur si pajtim. Është formuar një komitet nga përfaqësuesit e Këshillit dhe të Parlamentit Evropian. Detyra e tij është të arrihet marrëveshje për një tekst të përbashkët. Nëse arrihet në një tekst të përbashkët të dakortësuar, ai është objekt i një leximi të tretë në secilin institucion.

Pasi të dy institucionet të kenë arritur marrëveshje për një tekst të përbashkët, thuhet se ai ka marrë miratimin nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian. Pastaj botohet në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe bëhet ligj.

Nëse të dy institucionet nuk mund të bien dakord për një tekst të përbashkët, procedura përfundon dhe propozimi i Komisionit refuzohet.

Agjencitë e Bashkimit European

Agjencitë e Bashkimit European. Agjencitë e Bashkimit European janë autoritete publike të krijuara sipas së drejtës europiane dhe gëzojnë personalitet juridik.

Agjencitë e Bashkimit European janë krijuar nga një akt i legjislacionit dytësor të Komunitetit për të kryer detyra specifike teknike, shkencore ose administrative.

Agjencitë mund të ndahen në 4 nëngrupe në bazë të veprimtarisë së tyre:

1- Agjenci që ndihmojnë në funksionimin e tregut të brendshëm.

- a- Zyra për Harmonizim në Tregun e Brendshëm (OHIM) (Markat Tregtare dhe Dizajnët) me seli në Alicante;
- b- Zyra e Komunitetit për Larminë Bimore (CPVO) me seli në Angers, Francë ;
- c- Agjencia Europiane për Vlerësimin e Prodhimeve Mjekësore (EMA) me seli në Londër;
- d- Autoriteti European për Sigurinë Ushqimore (EFSA) me seli në Parma, Itali;
- e- Agjencia Europiane për Sigurinë Detare (EMSA), Lisbonë, Portugali;
- f- Agjencia Europiane për Sigurinë Ajrore (EASA) Kolonjë, Gjermani.

2- Qendra monitorimi.

- a- Agjencia Europiane e Mjedisit (EEA) me seli në Kopenhagen;
- b- Qendra Europiane e Monitorimit për Drogat dhe Toksimaninë (EMCDDA) me seli në Lizbonë;
- c- Qendra Europiane e Monitorimit për Racizmin dhe Ksenofobinë (EUMC) me seli në Vienë.

3- Agjenci që nxisin dialog social në nivel evropian.

- a- Qendra Europiane për Zhvillimin e Formimit Profesional (CEDEFOP) me seli në Selanik
- b- Fondacioni European për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe të Punës (Dublin)
- c- Agjencia Europiane për Sigurinë në punë dhe Shëndetin (Bilbao)

4- Agjenci që kryejnë programe dhe detyra në emër të Bashkimit European në fushat e tyre përkatëse të ekspertizës.

- a- Fondacioni European i Trainimit (ETF) me seli në Torino;
- b- Qendra e Përkthimit për Organet në Bashkimin European (CdT) me seli në Luksemburg;
- c- Agjencia Europiane e Rindërtimit (ERA) me seli në Selanik.

- Agjencia Komunitare për Kontroll të Peshkimit (AKKP) - Vendi: Vigo, Spanjë (selia e përkohshme: Bruksel, Belgjikë),
- Agjencia Ekzekutive Edukative, Audiovizuale dhe Kulturore (AEEAK) Vendi - Bruksel, Belgjikë
- Eurojust - Vendi: Hagë, Holandë
- Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Koordinimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të BE-së (Frontex) - Vendi: Varshavë, Poloni
- Qendra Evropiane për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjes (QEPKS) - Vendi: Stokholm, Suedi
- Agjencia Evropiane e Kimikateve (AEK) - Vendi: Helsinki, Finlandë
- Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (AEM) - Vendi: Bruksel, Belgjikë
- Autoriteti Evropian i Sistemit Satelitor të Navigimit Global (GSA) - Vendi: Bruksel, Belgjikë (selia e përkohshme)
- Instituti Evropian për Barazi Gjinore - Vendi: Vilnius, Lituani
- Agjencia Evropian e Rrjetit dhe Sigurisë së Informacionit (AERSI) - Vendi: Heraklion (Kretë), Greqi
- Kolegji i Policisë Evropiane (CEPOL) - Vendi: Bramshill, Mbretëri e Bashkuar
- Zyra e Policisë Evropiane (Europol)
- Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore (AEDT) - Vendi: Vjenë, Austri
- Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë (EIBESS) - Vendi: Paris, Francë
- Qendra Satelitore e Bashkimit Evropian (QEBE) - Vendi: Torrejón de Ardoz, Spanjë
- Agjencia Ekzekutive për Programin e Shëndetit Publik (AEPSP) - Vendi: Luksemburg

2. Politika e Përbashkët Bujqësore në BE.

BE-ja në vitin 2016 krijoi një prodhim të brendshëm bruto (PBB) prej 16.477 trilionë dollarë amerikanë, që përbën rreth 22.2% të PBB-së nominale globale dhe 16.9% kur matet në drejtim të barazisë së fuqisë blerëse.

Europa është një nga rajonet kryesore në botë të prodhimit bujqësor, konsumit dhe flukseve tregëtare në rang global. BE konkuron në botë për tregjet e eksportit për shumë nga mallrat bujqësore. Përbërjen e produktit bujqësor produktivitetin dhe konkurrencën e Evropës.

Shqipëria ka marrë statusin e vendit kandidat në vitin 2014.

Procesi i futjes së Shqipërisë në Bashkimin Europian do të kërkojë zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit të ri.

Futja e Shqipërisë në Evropë kërkon një proces njohje në lidhje me rregullat dhe procedurat që do të zbatohen në Shqipëri në kuadër të këtij integrimi.

Qëllimi i këtij projekti është të ndihmojë në rritjen e njohurive të fermerëve shqiptarë për legjislacionin evropian si edhe të përhapë njohuri reale për këtë proces.

Projekti ka tre objektiva themelore:

1. Të identifikojë aktorët që operojnë në bujqësinë organike në Shqipëri.
2. Të kontribuojë në një bashkëpunim sa më të mirë mes tyre.
3. Të japë njohuri konkrete mbi procedurat që duhet të plotësojë Shqipëria në momentin e nënshkrimit të marreveshjes me BE. (Të drejtat dhe Detyrimet / Të mirat dhe vështirësitë e pritshme.

TRAKTATI PËR FUNKSIONIMIN E BASHKIMIT EVROPIAN

(26.10.2012 Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian C 326/47)

Neni 38

1. Bashkimi përcakton dhe zbaton një politikë të përbashkët të bujqësisë dhe peshkimit.

Tregu i brendshëm do të shtrihet në bujqësi, peshkim dhe tregtinë e prodhimeve bujqësore. “Produktet bujqësore” nënkupton produktet e tokës, të kafshëve (*në fermë*) dhe të peshkimit dhe produktet e përpunimit të fazës së parë që lidhen direkt me këto produkte. Referencat në politikën bujqësore të përbashkët ose në bujqësi dhe përdorimi i termit "bujqësor" do të kuptohet si referencë edhe për peshkimin, duke pasur parasysh karakteristikat specifike të këtij sektori.

PPB- Politika e Përbashkët Bujqësore

Në Traktat është përcaktuar që:

“Tregu i përbashkët për produktet bujqësore duhet të jetë i shoqëruar me krijimin e një politike të përbashkët bujqësore midis “Shteteve Anëtare”.

Eliminimi i tarifave doganore dhe detyrimeve me natyrë fiskale me efekt të njejtë me tarifat doganore Brenda komunitetit.

Eliminimi i kufizimeve sasiore dhe masave me efekt dhe natyrë të njejtë.

- (Nje kufizim sasior është një masë nacionale e cila përcakton volumin dhe/ose sasinë e import/eksporteve të produkteve jo duke u ngritur detyrimet doganore të çdo natyre por duke vendosur limite për importin/eksportin e tyre.)

Eliminimi i masave diskriminuese nga sistemi nacional i tatimeve.

E drejta e mallrave me origjinë jo komunitare të lëvizin lirshëm në komunitet mbas plotësimit të detyrimeve mbi importin e tyre në një shtet anëtar.

PPB DHE PESË OBJEKTIVAT E TRAKTATIT

Rritja e efijencës në bujqësi.(produktiviteti i punës)

Rritja e standartit të fermerëve (nivelit të jetesës)

Stabilizim i tregjeve bujqësore (tepricat e prodhimit të mos dëmtojnë tregun)

Sigurimi i ofertës së nevojshme (ka të bejë me atë që brenda komunitetit të ketë ushqim të mjaftueshem edhe në raste krizash.)

Çmime të arsyeshme për konsumatorët (çmimet e EU janë më të larta krahasuar me ato botërore (perveç viteve 1973 dhe 1995) ndryshe nëse EU nuk do të nderhynte në mënyrë të vazhdueshme duke subvencionuar tepricën e prodhimit dhe të behej importuese neto. Çmimet e EU janë ndryshe nga ato të tregut botëror. EU nëpërmjet subvensioneve të eksporteve ka ndikuar në uljen e çmimit botëror.

Objektivat e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural synojnë:

- a) Rritjen e të ardhurave për popullsinë rurale , duke rritur mirëqënien e saj, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe jetesës si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë. Rritjen e prodhimit nëpërmjet nxitjes së konkurrencës dhe progresit teknik si dhe garantimit të një përdorimi optimal të faktorëve të prodhimit dhe në veçanti të punës.
- b) Stabilitetin e tregut, duke garantuar qëndrueshmëri në prodhimin bujqësor.
- c) Cilësinë dhe sigurinë ushqimore duke garantuar që zinxhiri ushqimor të ketë cilësi të qëndrueshme dhe të mos shkaktojë pasoja të dëmshme në shëndetin e njerëzve.
- d) Në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit duke garantuar që bujqësia të ruaje burimet natyrore.
- e) Në uljen e varferisë , në zvogëlimin e pabarazisë ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme si edhe të prapambetjes në zonat rurale më pak të favorizuara me synim ngadalësimin e largimit të popullsisë nga fshatrat si edhe duke fuqizuar biznesin e vogël dhe të mesëm.

Niveli i taksave ndaj vendeve të treta mbas vitit 1995 është i njëjtë për të gjitha vendet e komunitetit.

Historiku i PPB

Viti 1957 - 25% e fuqisë punëtore ishte e angazhuar në bujqësi.

- Struktura e fondit të tokave nuk ofronte mundësi për prodhimtari ekonomike.
- Pjesa më e madhe e fermave nuk ishin të gatshëm për prodhim të specializuar pasi dy të tretat e fermerëve kishin 1-10 Ha.
- Ndikimet e motit dhe fatkeqësive natyrore (thatësi, vërshime, sëmundje) solli një prodhim më të vogël.
- Ndërsa në rastet kur kishte kushte të volitshme natyrore prodhimi i tepërt nuk ishte parashikuar si do të përdorej.

1962 Lindi Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB)

Thelbi i politikës është çmime të mira për fermerët. Me kalimin e çdo viti, fermerët prodhojnë më shumë ushqim. Dyqanet janë plot me ushqim me çmime të përballueshme.

1970 – 1980 – Menaxhimi i furnizimit. Fermerët janë aq produktive sa që janë duke prodhuar më shumë ushqime sa është e nevojshme. Tepëricat janë ruajtur dhe janë çuar ne “mallet e ushqimit”. Janë marrë masa të veçanta për të lidhur prodhimin me nevojat e tregut. (ketu është momenti kur fillohet orientimi i produkteve bujqësore).

Historiku PPB

1992 – PPB zhvendoset nga mbështetje e tregut për të mbështetur prodhuesit. Mbështetja ndaj çmimit është zvogëluar dhe është zëvendësuar në pagesa diekte të ndihmes për fermerët. Ata inkurajohen të jenë më miqësorë me mjedisin. (Shfaqet koncepti i Zhvillimit të Qendrueshëm).

1990 – PPB fokusohet më shumë në cilesinë e ushqimit. Politika prezanton masa të reja për mbështetjen e investimeve në ferma, training për të përmirësuar përpunimin dhe marketimin e produkteve. Hapa janë marrë për të mbrojtur ushqime tradicionale dhe rajonale. Legjislacioni i pare European eshte zbatuar.

2000 – PPB përqëndrohet më shumë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të Evropës rurale. Në të njëjtën kohë , reformat që filluan në vitet 1990 janë të vazhdueshme në mënyre që fermeret të jenë më të orientuar drejt tregut.

2003 – PPB shkurton lidhjen mes subvensioneve dhe prodhimit. Fermerët janë të orientuar drejt tregut duke pasur parasysh kufizimet specifike të bujqësisë Evropiane.

2011 – PPB Një reformë e re PPB kërkon të forcojë konkurrencën ekonomike dhe ekologjike në sektorin e bujqësisë, për të nxitur risi, për të luftuar ndryshimet e klimës dhe për të mbështetur punësimin në zonat rurale.

Politika e përbashkët bujqësore (PPB) është një sistem i ndihmave dhe programve bujqësore të Bashkimit Evropian. Deri në vitin 1992 shpenzimet për bujqësinë nga Bashkimi Evropian përbënin afërsisht 61% të buxhetit. Në vitin 2013 shpenzimet tradicionale të PPB u pergjysmuan (në 32 %).

Shpenzimet për PPB përbëhen kryesisht nga shpenzimet për ti garantuar prodhuesit çmimin minimal dhe për ti dhënë subvensione për të korrur në mënyrë që fermerët të garantojnë një nivel të ardhurash.

Ndër qëllimet dhe objektivat kryesore që synon të realizojë kjo politikë e përbashkët mund të listojmë:

- Përmirësimin e rendimenteve prodhuese.
- Garantimin e një standarti jetësor për fermerët e BE.
- Stabilizimin e tregjeve bujqësore.
- Garantimin e furnizimit me produktet bujqësore.
- Garantimin e produkteve ushqimore me çmime të arsyeshme për konsumatorët.

Ndërhyrja në çmimin nëpërmjet politikës së përbashkët bujqësore mbulon vetem këto produkte:

-
- | | |
|---|--------------------------------------|
| -Drithrat, oriz, patate, fara luledielli; | - Foragjere të thata; |
| -Qumësht dhe nënproduktet e tij, vera , mjalti; | - Mish viçi / derri / qengji / vezë; |
| -Sheqer; | - Fruta dhe perime; |
| -Pambuk; | - Bizele; |
| -Vaj ulliri; | - Duhan; |
| -Kerp; | - Lule dhe bime të gjalla; |
- Ushqim për kafshët.

Në regjimin e tregtisë së jashtme mbulohen më shumë produkte se nga PPB.Kjo për të limituar konkurrencën midis produkteve që prodhohen në BE dhe atyre që prodhohen jashtë BE.

Rregullorja Europiane e Bioteknologjisë 90/220/EEC “Mbi lejimin e organizmave të Modifikuar Gjenetikisht”

Një rregull që të etiketohet produkti i cili të ketë qoftë edhe 1% produkt të modifikuar gjenetikisht.

PPB në të ardhmen synon:

- Një pagesë e “gjelbërt” për ruajtjen e produktivitetit afatgjatë dhe ekosistemeve.
- Investime plotësuese në hulumtim dhe inovacion.
- Një zinxhir ushqimi më konkurrues dhe të balancuar.
- Rritje e punësimit rural dhe sipërmarrjes.
- Një PPB më e thjeshtë dhe më efikase.

Ligji Nr. 106/2016 Për prodhimin giologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre.

Ky ligj është përafruar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 834/2007, datë 28 qershor 2007, “Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) 2092/91”, të ndryshuar. Numri CELEX: 32007R0834, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L Nr. 189, dt. 20.7.2007, faqe 1-23.

Ky ligj zbatohet për çdo operator të prodhimit, përgatitjes, transportit dhe shpërndarjes së produkteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, me përjashtim të operatorëve të kateringut.

KREU V KONTROLLET Neni 30 Sistemi i kontrollit; Tregtia me vende të tjera, etj.

Anakronime

Bujqësia organike: Prodhimi organik është një sistem i përgjithshëm i menaxhimit të fermave dhe prodhimit të ushqimit që ndërthur praktikat më të mira mjedisore, një nivel të lartë biodiversiteti, ruajtjen e burimeve natyrore, aplikimin e standardeve të larta të mirëqenies së kafshëve dhe një metodë prodhimi në përputhje me preferencat e konsumatorëve të caktuar për produkte të prodhuar duke përdorur substanca dhe procese natyrore.

Fermer aktiv: Për të shmangur dhënien e ndihmës ekonomike për individë dhe kompani, veprimtaria bujqësore e të cilëve është marxhinale, pagesa direkte dhe pagesa për fermerët jepen vetëm për fermerët aktivë si dhe ata që vërtetojnë se bujqësia nuk është një veprimtari marxhinale në ekonominë e tij.

Aktiviteti bujqësor: Reforma e vitit 2013 për Politikën e Përbashkëta Bujqësore parasheh përcaktimin që, me qëllim të marrjes së pagesave direkte, fermerët duhet të kenë një aktivitet bujqësor i cili nënkupton:

1. Prodhimin, ushqimin ose rritjen e produkteve bujqësore apo blektorale, përfshirë korrjen, nxjerrjen e qumështit, mbarështimin e kafshëve dhe mbajtjen e kafshëve për qëllime bujqësore; ose
2. mirëmbajtja e hapësirë bujqësore në një hapësirë që e bën atë të përshtatshëm për kullotje ose kultivim pa ndonjë investim apo kusht të veçantë përgatitor që tejkalon metodat dhe makineritë e zakonshme bujqësore, bazuar në kriteret që përcaktohen nga shtetet anëtare në bazë të një kornize ligjore të krijuar nga Komisioni; ose
3. kryerja e një veprimtarie minimale që do të vendoset nga vendet anëtare në zonat bujqësore të mbajtura natyrisht në një gjendje të përshtatshme për kullotje ose kultivim.

Politika e cilësisë së produktit bujqësor:

Për t'iu mundësuar fermerëve të komunikojnë dhe paraqesin cilësitë, karakteristikat dhe atributet e produkteve të tyre dhe t'u japin konsumatorëve informacionin e duhur, Bashkimi Evropian ka zhvilluar disa sisteme të cilësisë të cilat fermerët dhe prodhuesit mund të përdorin për produktet e tyre duke siguruar që produktet dhe / ose metodat e prodhimit plotësojnë një sërë specifikimesh.

Përkufizimet ligjore të këtyre sistemeve, së bashku me procedurat për regjistrimin e emrave specifike dhe për kontrollin e përdorimit të tyre, janë dhënë në Rregulloren (BE) Nr 1151/2012 për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore.

1. Emërtimi i mbrojtur i origjinës (PDO). Ky është një emër që identifikon një produkt me origjinë nga një vend, rajon ose në raste të jashtëzakonshme, një shtet, cilësia ose karakteristikat e të cilit janë në thelb ose ekskluzivisht për shkak të një mjedisi të veçantë gjeografik me faktorët e tij të natyrshëm natyror dhe njerëzor dhe i cili prodhohet, përpunohet dhe përgatiten në atë të përcaktuar zona gjeografike. Shembuj përfshijnë Jamón de Teruel nga Spanja dhe djathë Comte nga Franca. Një etiketë specifike është zhvilluar për të treguar produktet me një PDO.

2. Indikacioni gjeografik i mbrojtur (PGI). Ky është një emër i cili identifikon një produkt me origjinë nga një vend, rajon ose vend i caktuar, cilësia, reputacioni ose karakteristika tjetër e të cilit i atribuohet në thelb gjeografisë së tij; dhe të paktën një nga hapat e prodhimit të të cilit zhvillohet në zonën e caktuar gjeografike. Shembuj përfshijnë Mortadella Bologna nga Italia. Një etiketë specifike është zhvilluar për të treguar produktet me një PGI.

3. Specialiteti tradicional i garantuar (TSG). Ky është një emër që përshkruan një produkt ose produkte ushqimor specifik që vjen nga mënyra e prodhimit, përpunimit ose përbërjes që korrespondon me praktikën tradicionale për atë produkt ose ushqim, ose i cili prodhohet nga lëndë të para ose përbërës që janë ato që përdoren tradicionalisht. Shembuj përfshijnë birrat e specializuara belge, të tilla si Gueuze dhe Kriek, dhe Kalakukko, një bukë finlandeze me peshk dhe mish të pjekur brenda saj. Siç është rasti për PDO-të dhe PGI-të, një etiketë specifike është zhvilluar për produktet TSG.

4. Kushtet e cilësisë opsionale (OQT). Përveç tre skemave të mësipërme, ekziston një kategori tjetër e cila është opsionale. Këto janë terma që kanë të bëjnë me një karakteristikë të një ose më shumë kategorive të produkteve, ose me një karakteristikë të veçantë bujqësore ose përpunuese, i cili zbatohet në zona të veçanta, përdorimi i të cilave shton vlerë në produkt në krahasim me produkte të një lloji të ngjashëm dhe që ka një dimension evropian. Këto terma janë krijuar për të lehtësuar komunikimin brenda tregut të brendshëm të karakteristikave të shtimit të vlerës ose cilësive të produkteve bujqësore nga prodhuesit e tyre. Një shembull është termi 'produkt malor'.

Skema Themelore e Pagesave (BPS): Sipas rregullave të Politikës së Përbashkët Bujqësore 2007-2013, fermerët morën pagesa direkte qoftë nëpërmjet me Skemës së Pagesave të Vetme ose me Skemës së Pagesave të Zonës së Re. Reforma e Politikës së Përbashkët Bujqësore e vitit 2013 e zëvendësoi Skemës së Pagesave të Vetme me Skemën Themelore të Pagesave e cila hyri në fuqi që nga viti 2015. Skema Themelore e Pagesave operohet në bazë të të drejtave të pagesave të alokuara për fermerët në vitin e parë të aplikimit të skemës dhe aktivizohet çdo vit nga fermerët.

Kualifikimi për Skemën Themelore të Pagesave ose, sipas rastit, Skema e Pagesave me një Zonë të Vetme është një parakusht që fermerët të marrin pagesa të tjera direkte siç janë pagesa e gjelbër direkte, pagesa rishpërndarëse, pagesa për zonat me kufizime natyrore ose të tjera specifike si edhe pagesa për fermerët e rinj.

Fermer i ri: Një person që është 40 vjeç ose më pak në momentin e paraqitjes së një kërkesë për ndihmë, i cili posedon aftësi të përshtatshme profesionale dhe që drejton për herë të parë një njësi bujqësore.

Përjashtimet nga bllokimi (ndihma shtetërore):

Në kontekstin e ndihmës shtetërore, Komisioni Evropian ka përcaktuar kategori të caktuara të ndihmave (shih Rregulloren (BE) Nr. 702/2014). Shtetet anëtare mund të japin ndihmë shtetërore në këto kategori, pa pasur nevojë të paraqesin një njoftim në Komision. Nëse një ndihmë e tillë respekton kushtet e hollësishme të përcaktuara në këtë rregullore, vendet anëtare duhet të informojnë vetëm Komisionin për qëllimin e tyre dhe Komisioni më pas do të publikojë masën në mënyrë që përfituesit të informohen dhe të kenë siguri juridike në lidhje me ligjshmërinë e ndihmës.

Grupet e dialogut civil

Këto janë grupe të përfaqësuesve të organizatave në nivelin Evropian nga shoqëria civile. Organizatat përfshijnë shoqata profesionale dhe organizata të tjera joqeveritare të cilat janë të përfshira në bujqësi, ekonominë rurale, prodhimin dhe përpunimin ushqimor, tregti bujqësore, mjedis, mbrojtje të konsumatorit dhe çështje të tjera të lidhura me to. Ata takohen me shërbimet e Komisionit disa herë në vit.

Ekzistojnë 13 grupe të tilla. Ata luajnë një rol këshillues dhe nuk janë të përfshirë në hartimin ose miratimin e legjislacionit.

Përputhshmëria e tërthortë: Për të marrë pagesa direkte dhe disa forma të tjera të mbështetjes, fermerëve u kërkohet të respektojnë disa rregulla. Kjo kërkesë njihet si pajtueshmëri e kryqëzuar. Këto rregulla kanë të bëjnë me sigurinë e ushqimit, shëndetin e kafshëve, shëndetin e bimëve, klimën, mjedisin, mbrojtjen e burimeve ujore, mirëqenien e kafshëve dhe gjendjen në të cilën mirëmbajtet toka bujqësore. Ekzistojnë dy komponentë të këtyre rregullave: kërkesat ligjore për administrimin dhe kushtet e mira bujqësore dhe mjedisore. Nëse një fermer zbulohet se nuk i respekton këto rregulla, pagesa e tij direkte mund të zvogëlohet.

Fondet strukturore dhe fondet e investimeve europiane (ESIF): Këto përfshijnë fondet e mëposhtme të Bashkimit Evropian: Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural, Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal, Fondi Social Evropian, Fondi i Kohezionit dhe Fondi Evropian Detar dhe Peshkimit.

Kreditë për eksport: Brenda kontekstit të Organizatës Botërore të Tregtisë, këto janë stimuj të veçantë, siç janë financimi i drejtpërdrejtë, ri-financimi, mbështetja e normës së interesit, sigurimi i kredisë për eksport dhe garancitë, faturimi i shtyrë dhe çdo formë tjetër e përfshirjes, direkte ose indirekte, të cilat ofrohen nga qeveria për të inkurajuar eksportet.

Pagesa direkte e gjelbërt: Reforma e Politikës së Përbashkët Bujqësore për vitin 2013 prezantoi një pagesë të drejtpërdrejtë të gjelbërt e cila u paguhet fermerëve me kushtin që ata të ndërmarrin praktika të dobishme për klimën dhe mjedisin. Shtetet anëtare duhet të vecojnë 30% të pagesave të drejtpërdrejtë për pagesa direkte të gjelbërt.

Taksë: Në kontekstin e Politikës së Përbashkët Bujqësore, termi taksë mund të përdoret në tre kuptime:

1. Një pagesë nga fermerët në një fond për një aktivitet specifik siç është promovimi i shitjes së produkteve bujqësore brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian,
2. Një pagesë nga fermerët ndaj qeverisë në këmbim të marrjes së shërbimeve të veçanta, siç është p.sh. kontrolli i sëmundjeve të kafshëve.
3. Një pagesë nga fermerët ose përpunuesit në rast se prodhimi i tyre tejkalon një kufi të caktuar prodhimi. Kjo lloj i një takse aktualisht vlen vetëm në sektorin e sheqerit. Përpunuesit e panxhar sheqerit që vendosin në tregun e brendshëm një sasi sheqeri që tejkalon kuotën e tyre të prodhimit, janë të detyruar të paguajnë një taksë.

3. **Procesi “Screening” gjatë negociatave.**

Procesi Screening

Procesi Screening realizohet në mënyrë të përbashkët nga Komisioni European dhe vendi anëtar që nënshkruan marrëveshjen.

Ky proces mbikqyr sa është përafruar legjislacioni kombëtar me atë të BE dhe miraton një plan të detajuar në vijueshmëri për përafrimin e tij.

Çdo kapitull i traktatit negociohet më vete dhe evidentohet më vete përputhshmëria specifike e legjislacionit.

Kapitujt e marrëveshjes (aktualisht janë 35) përfaqësojnë bazën e negociatave për çdo vend kandidat.

Çdo kapitulli të marrëveshjes i korespondon një degë e veçantë e të drejtës europiane për të cilën nevojiten reforma për të arritur kushtet për anëtarësim nga vendet candidate. Kapitujt e veçantë shqyrtohen dhe vlerësohen në mënyrë të veçantë deri sa kapitulli të mbyllet.

Vendeve candidate u kërkohet të adoptojnë infrastrukturën e tyre administrative dhe institucionale dhe të sjellin në të njëjtën linjë legjislacionin e tyre me atë të BE-së në bazë të një plani konkret.

Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Kapitulli i bujqësisë përmban një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme.

Politikat e PPB kërkon ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe cilësisë të tilla si agjencia e pagesave, sistemin e integruar dhe te kontrollit te pagesave (IACS), dhe kapacitetin për të zbatuar masat e zhvillimit rural.

Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes direkte në fermë dhe për zbatimin e dispozitave legjislative për organizimin e përbashkët të tregut për produkte të ndryshme bujqësore.

Plani i punës si gjatë Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit ashtu edhe gjatë negociatave të anëtarësimit ka në themel bashkëpunimin me BE-në për modernizimin dhe rikonstruktimin e Sektorit të Bujqësisë dhe Agroindustrisë, duke përafruar gradualisht legjislacionit shqiptar me rregullat dhe politikat e BE me qëllim rritjen e cilësisë së produkteve agroushqimore përmes:

- përmirësimit teknologjik,
- metodave dhe teknikave të reja të menaxhimit të integruar të sistemeve të prodhimit dhe reduktimit të kimikateve,
- përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis*, dhe
- përmbushjen e standardeve të BE-së.

Prioritetet kryesore gjatë negocimit.

- Rritja e aftësive konkurruese duke rritur në mënyrë progressive standartet në kuadër të përafrimit të legjislacionit.
- Rivendosja, ruajtja dhe rritja e ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pylltaria.
- Zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i zonave rurale si dhe reduktimin e varfërisë në këto zona.
- Transferimi i njohurive dhe inovacionit në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale dhe ndihmë për zbatimin e politikave të zhvillimit rural.
- Stabilizimi i të ardhurave të fermerëve - mbështetje direkte për fermerët dhe skema të tjera mbështetëse.
- Përmirësimi i infrastrukturës rurale.
- Menaxhimi dhe zvogëlimi i reziqeve në bujqësi.
- Zhvillimi institucional, zbatimi i kërkesave rregullative të BE-së.

Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare.

Politikat e sigurisë ushqimore zbatohen në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit në përputhje me parimin nga ferma tek piruni/ nga stalla tek tavolina.

Këto parime përfshijnë:

- parimin parandalues i cili kërkohet për të siguruar mbrojtjen e shëndetit në Komunitet dhe
- parimin e transparencës për të siguruar që konsumatorët, palët e tjera dhe partnerët tregtarë të kenë besim në proceset e vendim-marrjes të destinuara për forcimin legjislativ të ushqimit, bazën e saj shkencore dhe strukturat dhe pavarësinë e institucioneve që mbrojnë shëndetin dhe interesat e tjera.

Ky kapitull përfshin gjithashtu edhe rregulla të detajuara në fushën e veterinarisë, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, sigurinë e ushqimeve me origjinë shtazore në tregun e brendshëm.

Në fushën e fitosanitetit, rregullat e Bashkimit Evropian përfshijnë çështjet e cilësisë së farërave, materialet e mbrojtjes së bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve, etj.

Struktura shtetërore e negociatave

Struktura shtetërore e negociatave është ngritur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Objektivat e strukturës së negociatave

Struktura e negociatave ka si qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- a) realizimin e procesit të shqyrtimit të përafrimit dhe të vlerësimit të legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Evropian (screening);
- b) përcaktimin dhe hartimin e qëndrimeve negociuese të Republikës së Shqipërisë për secilin kapitull të acquis të Bashkimit Evropian;
- c) negocimin dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.


STRUKTURA E NEGOCIATAVE

1. Struktura përgjegjëse për negociatat përbëhet nga:

- a) Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian;
- b) Delegacioni Shtetëror;
- c) grupi negociator;
- ç) Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- d) Sekretariati i Integritimit Evropian;
- dh) grupet ndër-institucionale të punës;
- e) Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian.

Platforma e partneritetit për integrimin Evropian (IX)

1. Informimi, konsultimi, komunikimi dhe përfshirja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe në procesin e stabilizim-asociimit realizohen nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.
2. Pjesëmarrja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, biznesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian për monitorimin e politikave publike gjatë procesit të negocimit nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, si dhe dhënia e ekspertizës në fusha të ndryshme të *acquis* të Bashkimit Evropian është e hapur për to, sipas fushës përkatëse të kompetencës.
3. Format e pjesëmarrjes, funksionimi dhe struktura institucionale e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian miratohen me urdhër të Kryeministrit.



IPSED –Instituti për Promovimin e Zhvillimit
Social dhe Ekonomik

Tel: +355 69 60 60 363

Email: delina.nano@ipsed.al

Adresa: Rr.Asim Zeneli /9

Tiranë, Shqipëri.

ISP-Instituti për Politikat e Qëndrueshme

Tel: +355 69 99 13 820

Email: info@isp-albania.org

Adresa: Rezidenca Kodra e diellit. Rr e Jaseminëve.

Nd.22, Nr. 170.

Tiranë, Shqipëri.